

SHOQERIA TREGTARE
UNITED MOTORS SHPK
TIRANE

VENDIM NR. _____ DATE _____
I ORTAKUT TE VETEM TË SHOQËRISË TREGTARE
UNITED MOTORS SHPK, TIRANE

Në Tiranë, sot në datën 02, muaji Prill, viti 2020, u mbledh Ortaku i Vetem i Shoqërisë Tregtare "UNITED MOTORS" SHPK, Tiranë, në selinë e saj, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- a) Shqyrtimin e veprimtarisë tregtare dhe tregësive financiare të Shoqërisë Tregtare "UNITED MOTORS" SHPK, Tiranë, për vitin financiar në vazhdim 2019 si dhe ecuria e saj në të ardhmen;
- b) Shqyrtimin e projektit të bashkimit (përthithjes) me shoqëritë tregtare "UNITED MOTORS" SHPK, Tiranë dhe "AUTO MASTER" SHA, Tiranë, ku shoqëria tregtare "AUTO MASTER" SHA, Tiranë është përthithesja dhe shoqëria "UNITED MOTORS" SHPK, Tiranë është e përthithura;
- c) Caktimin e Ekspertit Kontabel të Rregjistruar për të kryerë aktin e ekspertimit për bashkimin e shoqërive.

Asambleja e Ortakeve, pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E

Shoqëria "UNITED MOTORS" SHPK, me seli në Tiranë, Këshat Mezez, Rruga dytesore Tiranë – Durrës, Km. 4, Godina Nr. 115, Kati 0 dhe Kati 1, Lagja Mezez, është themeluar me datë 21.03.2007 dhe është regjistruar si person juridik me datë 28.03.2007, pranë Qendres Kombetare të Biznesit (Q.K.B), me numër identifikimi NIPT-i K71616010]. Në bazë të aktit të themelimit dhe të statutit, kjo shoqëri ka perfaqësues ligjor z. Ardi AFEZOLLI dhe është krijuar dhe zotërohet nga Ortaku i Vetem i saj si më poshtë:

- Shoqëria UNION GRUP SHA zoteron 100% (njëqind) të kapitalit, në shumën 59,912,800leke (Pesëdhjetecente milion e nentëqindëdhjetë mijë e tetëqind), të ndara në 100 pjesë kapitali (kuota) me vlerë nominale 599,128 leke (kuota) dhe perfaqësohet në këtë mbledhje sipas Vendimit të Ortakeve të Shoqërisë 10.03.2020 nga ortaku Z.Varuzhan Piranjani;

Gjatë shqyrtimit të veprimtarisë tregtare dhe tregësive financiare të Shoqërisë Tregtare "UNITED MOTORS" SHPK, Tiranë, Ortaku i Vetem konstaton se kjo shoqëri ka disa vite që rezulton me humbje, prandaj për përmirësim që rrjedhin nga perdorimi i të njëjtave asete pune dhe nga ngushërimi i ndjeshëm i hapësirave të punës, të behet bashkimi i kësaj shoqërie me shoqërinë "AUTO MASTER" SHA, Tiranë nëpërmjet metodës së përthithjes, ku baza e nisjes për bashkimin do të jete tregësitë e Pasqyrave Financiare të datës 31.12.2019, ndërsa aktiviteti i vitit 2020 do të konsiderohet i perbashkët deri në datën kryerjes së procesit të përthithjes nga QKB.

Për këto arsye, Ortaku i Vetem i Shoqërisë tregtare "UNITED MOTORS" SHPK, Tiranë, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

V E N D O S I :

1. Të pranohet bashkimin e shoqërive tregtare "UNITED MOTORS" SHPK, Tiranë, me shoqërinë "AUTO MASTER" SHA, Tiranë, nëpërmjet formes së përthithjes, mbi bazën e të dhënave të Pasqyrave Financiare të datës 31 Dhjetor 2019;
2. Caktimin e z. Lavdimir FUSHA "Ekspert Kontabel i Rregjistruar", anetar i Institutit të Eksperteve Kontabel të Rregjistruar – IEKA me license Nr. 97, date 10.01.2001, për kryerjen e aktit të ekspertimit

Varuzhan Piranjani

SHOQERIA TREGTARE
UNITED MOTORS SHPK
TIRANE

ne llogaritjen e raportit te ortakeve ne kapitalin themeltar duke u nisur nga raporti i ortakeve ne kapitalin neto te shoqerise "AUTO MASTER" SHA, Tirane, pas bashkimit ;

3. Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare te Biznesit.
4. Autorizimin e Administratorit Z.Ardi Afzollli personalisht ose duke ushtruar te drejten e delegimit te persna te treta, te kryeje cdo veprim ne nevojshem prane organeve shteterore per zbatimin e ketij Vendimi.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQËRISË TREGTARE

"UNITED MOTORS" SHPK, TIRANE

UNION GRUP SHA
Përfaqesuar nga :

Z. Varuzhan PIRANJANI

Varuzhan Piranjani



